



**Analizë e politikave  
03/2017**



Schweizerische Eidgenossenschaft  
Confédération suisse  
Confederazione Svizzera  
Confederaziun svizra

Swiss Cooperation Office Kosovo

**MINISTRY OF FOREIGN AFFAIRS OF DENMARK**

**DANIDA** | INTERNATIONAL  
DEVELOPMENT COOPERATION

**Puna e Komisionit për Bujqësi, Pylltari, Mjedis e Planifikim Hapësinor dhe Agjenda  
Evropiane për vitin 2017**

---

*“Ky botim është realizuar me përkrahjen e projektit Promovimi i Shoqërisë Demokratike (DSP) – i financuar nga Zyra Zvicerane për Bashkëpunim në Kosovë (SCO-K) dhe Ministria e Punëve të Jashtme e Danimarkës (DANIDA) dhe menaxhuar nga Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF). Përmbajtja e këtij botimi është përgjegjësi e Institutit për Politika Zhvillimore dhe në asnjë mënyrë nuk mund të konsiderohet si qëndrim i SCO-K-së, DANIDA-së apo KCSF-së.”*

## **Përmbajtja**

<b>Hyrje .....</b>	<b>3</b>
<b>1. Bujqësia dhe pylltaria.....</b>	<b>4</b>
<b>2. Mjedisi dhe planifikimi hapësinor.....</b>	<b>5</b>
<b>4. Agjencitë e pavarura .....</b>	<b>6</b>
<b>Përfundime .....</b>	<b>7</b>

## Hyrje

Po bëhen një vit që në Kosovë hyri në fuqi Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit në mes të Republikës së Kosovës dhe Bashkimit Evropian. E konsideruar si një marrëveshje me rëndësi historike si në aspektin politik ashtu edhe atë ekonomik, ajo përmban një sërë detyrash dhe obligimesh që janë jetike për integrimin. Gjithashtu, raporti i Komisionit Evropian për Kosovën i publikuar tre muaj më parë vuri në dukje një sërë vështirësish të cilat duhet të i tejkalojnë institucionet e Kosovës në procesin e integritit. Komisioni për Bujqësi, Pylltari, Mjedis e Planifikim Hapësinor e ka mundësinë unike që këto sfida ose një pjesë të tyre të fus drejtëpërdrejtë në planin e vet të punës për vitin 2017. Raporti i KE për KE për Kosovën është një udhërrëfyes jo vetëm për progresin në shërbim të procesit të integritit por edhe pasqyrë e stadi të zhvillimit ekonomik-social në përgjithësi.

Instituti për Politika Zhvillimore (INDEP), monitoron dhe mbështetë punën e Komisionit që nga shtatori i vitit 2016. Kjo analizë është përgatitur për dy qëllime kryesore: të i ofrojë Komisionit një pasqyrë të problemeve kryesore që janë evidentuar si pjesë e sfidave në integrimin evropian dhe të shërbejë si një përkujtues për rolin që ka Komisioni në adresimin e tyre. Masat e propozuara reflektojnë dy funksione themelore të komisioneve parlamentare dhe Kuvendit në përgjithësi: funksionin ligjvënës dhe atë mbikëqyrës. Ne kemi propozuar edhe masa ligjore edhe mbikëqyrëse në shërbim të rritjes së llogaridhënjes ndaj publikut dhe organit më të lartë politik, Kuvendit të Republikës së Kosovës. Përfundimisht analiza mëton të shërbejë edhe si një pasqyrë e punës së Institutit për Politika Zhvillimore në programet për zhvillim të qëndrueshëm dhe qeverisje demokratike me qëllim të identifikimit të fushave ku duhen shtuar përpjekjet, resurset dhe impakti.

Analiza është ndarë në kapitla të veçanta dhe është bazuar në fushëveprimtarinë e Komisionit Bujqësi, Pylltari, Mjedis e Planifikim Hapësinor. Pas hyrjes, kapitulli i parë i kushtohet Tregtisë dhe Industrisë ku me theks të veçantë janë trajtuar fusha të ndryshme të ndara në dy nënkapituj kryesor, tregun dhe industrinë. Në kapitullin e zhvillimit ekonomik ne kemi vendosur energjinë, minierat dhe mineralet, ndërmarrjet publike dhe komunikimin elektronik dhe postar dhe si fusha kryesore. Në pjesën e infrastrukturës është trajtuar infrastruktura hekurudhore dhe ajo rrugore. Kësaj analize ia kemi kushtuar një pjesë të veçantë agjencive të pavarura dhe rolit që duhet të ketë Komisioni në adresimin e një numri të madh të çështjeve që ndërliken me funksionimin, funksionalizimin, mbikëqyrjen dhe pavarësinë e tyre.

Analiza është përpiluar duke marrë për bazë themelore çështjet e domosdoshme në procesin e integritit evropian. Asaj i janë shtuar edhe sqarimi i masave të mëparshme, ideve dhe diskutimeve në të kaluarën dhe opsionet politike. Në fund të pjesëve kryesore janë ofruar disa masa që INDEP i konsideron si rrugët më të mira për t'u ndjekur. Ato më pas janë përmbledhur në një listë të prioriteteve në fund të këtij dokumenti. Ne jemi të vetëdijshëm që jo me çdo gjë që do të lexoni në këtë analizë do të pajtoheni, dhe jo secila kapitlinë e nënkaptinë ka përfshirë gjithçka që duhet thënë për to. Në fund të fundit, ne synojmë që në vitin 2017 të hapim debatin i cili për një pjesë të konsiderueshme të këtyre temave ka munguar.

## 1. Bujqësia dhe pylltaria

Një nga fushat në të cilat Kosova pretendon të ketë përparësi të krahasuar. Në këtë kuptim, Komisioni i bujqësisë mund të luaj rol shumë të rëndësishëm në promovimin e këtij sektori përmes një legjislacioni favorizues dhe i cili merr në konsideratë vlerësimet e raportit të progresit. Prodhimtaria në bujqësi është e kufizuar nga madhësia relativisht e vogël e ngastrave të tokave, qasja e dobët tek tregjet e gjera dhe mungesa e investimeve në teknologji të reja.<sup>1</sup> Problemi i ngastrave të vogla nuk ka qenë thjeshtë i identifikuar nga Komisioni Evropian.

Ngastrat e vogla kanë qenë të identifikuara edhe në raportet e mëhershme të Komisionit Evropian dhe raporteve të brendshme. Ato ndikojnë në prodhimtarinë jo vetëm të produkteve bujqësore të ekonomisë prodhuese por edhe të sektorëve të tjerë që rrjedhin nga bujqësia. Kështu, një hulumtim i Institutit për Politika Zhvillimore (INDEP), mbi “Tregun e prodhimeve të qumështit dhe mundësisë së Kosovës për Zhvillim zhvilluar në vitin 2015 gjeti se pikërisht mungesa e ngastrave më të mëdha bujqësore ndikon në prodhimtarinë e qumështit, fuqisë për të mbuluar tregun vendor dhe kapacitetin për të filluar eksportin.

Megjithë benefitet nga Marrëveshja e Stabilizim Asociimit, efektet e saj në një pjesë të konsiderueshme të sektorëve bujqësor nuk do të ndihen. Neni 28 i marrëveshjes në lidhje me obligimet e BE-së ndaj Kosovës i rënditë një pjesë të madhe të këtyre sektorëve ndaj të cilëve BE-ja nuk do të heqë kufizimet.

1. Që nga data e hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje, BE-ja do të shfuqizojë të gjitha kufizimet sasiore, dhe masat me efekt të njëjtë mbi importet e produkteve bujqësore që e kanë origjinën në Kosovë.

2. Që nga data e hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje, BE-ja do të shfuqizojë detyrimet doganore dhe pagesat me efekt të njëjtë për importet e produkteve bujqësore që e kanë origjinën në Kosovë, përveç atyre të kërësve 0102 (gjedhe të gjalla), 0201, (mish gjedhi, i freskët ose i ftohur) 0202 (mish gjedhi, i ngrirë), 1701 (Sheqer nga kallami ose nga panxhari dhe sakarozë kimikisht e pastër, në formë të ngurtë), 1702 (Sheqerna tjera, duke përfshirë laktozën, maltozën, glukozën dhe fruktozën kimikisht të pastra në formë të ngurtë; shurupet e sheqerit që nuk përmbajnë aromatizues ose ngjyrosës; mjaltë arti ciale, qoftë e përzier ose jo me mjaltë natyrale; karamel) dhe 2204 (Verërat nga rrushi i freskët, përfshirë verërat e forti kuara; mushti i rrushit përveç atij të cekur në kreun 2009) i Nomenklaturës së Kombinar.<sup>2</sup>

Komisioni për Bujqësi, Pylltari, Mjedis e Planifikim Hapësinor në këtë periudhë mund të luaj rol shumë konstruktiv në zhvillimin e një debati se cilat janë masat që Kosova duhet të ndërmarrë për tejkalimin e këtyre kufizimeve. Një element tjetër në të cilin Kosova ka çaluar sipas raportit të Komisionit Evropian është çështja e rehabilitimit të tokave. Ka pasur probleme me sasinë e tokave

<sup>1</sup> Komisioni Evropian, (2016), Raporti për Kosovë, Stabiliteti Makroekonomik, Struktura e Ndërmarrjeve Sektoriale, e qasshme në [https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/pdf/key\\_documents/2016/20161109\\_report\\_kosovo.pdf](https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/pdf/key_documents/2016/20161109_report_kosovo.pdf) (qasur në janar, 2017)

<sup>2</sup> Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, (2015), Ligji Nr. 05/L-069 për Ratifikimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit në mes të Republikës së Kosovës në njërin anë dhe Bashkimit Evropian dhe Komunitetit të Energjisë Atomike në anën tjetër, neni 28, e qasshme në <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=11239> (qasur në janar, 2017).

të përfshira në skemën e rehabilitimit dhe në parandalimin e përdorimit ndërrimit ilegal të destinimit të tokave. Shqetësimi rritet kur kemi parasysh faktin se buxheti për mbështetjen e bujqësisë ka pësuar rritje të vazhdueshme vitet e fundit ndërkohë që efektet e saj janë lënë shumë për të dëshiruar. Skemat mbështetëse të shtetit duhen analizuar në raport me efektin që kanë pasur.

Në pjesën e pylltarisë, agjenda evropiane e Komisionit kufizohet në masë të madhe ga baza ligjore në fusha të tjera. Në pjesën e pylltarisë, niveli i prerjes ilegale të pyjeve është ende i madh për të folur për një zhvillim të qëndrueshëm të pyjeve.<sup>3</sup> Ndalimi i prerjeve ilegale, megjithatë, nuk mund të shpresojmë se do të ndodhë pa zhvillim të alternativave të ngrohjes siç janë ngrohjet qëndrore, projektet e kogjenerimit, zhvillimi i politikave të efikasitetit të energjisë etj. Të gjitha këto kanë ndikuar në një depyllëzim si pasojë e prerjes së pakontrolluar dhe ilegale të pyjeve.

Mbështetja e sektorit të bujqësisë dhe pylltarisë nga Bashkimi Evropian është paraparë edhe në Marrëveshjen e Stabilizim Asociimit.

Bashkëpunimi do të ketë si synim veçanërisht modernizimin dhe ristrukturimin e sektorit të bujqësisë dhe sektorit agro-industrial në Kosovë, posaçërisht që të arrij kërkesat sanitare të BE-së, të përmirësojë menaxhimin e ujit dhe zhvillimin rural si dhe të zhvillojë aspektet e lidhura me sektorin e pylltarisë në Kosovë dhe të mbështesë përafrimin gradual të legjislacionit dhe praktikave të Kosovës me *acquis* të BE-së.<sup>4</sup>

Meqenëse Bashkimi Evropian ka paraparë projekte për mbështetje të Kosovës pikërisht në modernizimin e sektorit të bujqësisë dhe pylltarisë, harmonizimi me bazën ligjore do të ishte shumë i nevojshëm. Sidomos këtu duhet thënë që për shembull për rritjen e madhësisë mesatare të fermës nevojitet patjetër bashkërendim i politikave me nivelin lokal dhe me akterët që kanë rol në formësimin e politikave fiskale.

## 2. Mjedisi dhe planifikimi hapësinor

Mjedisi përbën një nga elementet ku Kosova nevojitet të bëjë progres të përshpejtuar. Raporti i Komisionit Evropian për Kosovën vë në dukje mungesën e zbatimit të legjislacionit më tepër sesa e mungesës së tij. Edhe pse legjislacioni horizontal për ambientin është në fuqi, nevojitet fuqizimi i zbatimit të tij.<sup>5</sup> Në pjesën e mbrojtjes së mjedisit, raporti i Komisionit Evropian vë në dukje këto elemente më së shumti:

1. Në implementim të legjislacionit Kosova është në fazë krejt të hershme
2. Implementimi i dokumenteve vlerësimit të ndikimit në mjedis duhet fuqizuar dukshëm
3. Strategjia për kualitetin e ajrit duhet të vihet në zbatim
4. Duhet të kompletohet sistemi për matjen e kualitetit të ajrit

<sup>3</sup> Komisioni Evropian, (2016), Raporti për Kosovë, Politikat Sektoriale, Bujqësia dhe Peshkataria, e qasshme në [https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/pdf/key\\_documents/2016/20161109\\_report\\_kosovo.pdf](https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/pdf/key_documents/2016/20161109_report_kosovo.pdf) (qasur në janar, 2017)

<sup>4</sup> Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, (2015), Ligji Nr. 05/L-069 për Ratifikimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit në mes të Republikës së Kosovës në njërin anë dhe Bashkimit Evropian dhe Komunitetit të Energjisë Atomike në anën tjetër, neni 102, e qasshme në <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=11239> (qasur në janar, 2017).

<sup>5</sup> Komisioni Evropian, (2016), Raporti për Kosovë, Politikat Sektoriale, Bujqësia dhe Peshkataria, e qasshme në [https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/pdf/key\\_documents/2016/20161109\\_report\\_kosovo.pdf](https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/pdf/key_documents/2016/20161109_report_kosovo.pdf) (qasur në janar, 2017)

5. Në pjesën e mbeturinave (mbetjeve) Komisioni Evropian thekson se mungon edhe gjëja më bazike siç është ajo e definimit të qartë të termave në legjislacion të tillë si riciklimi e ripërdorja të cilët nuk janë sa duhet të qartë
6. Në pjesën e menaxhimit të ujërave ka nevojë të bëhet shumë në identifikimin e vendburimeve të ujërave dhe një sistemi të menaxhimit të tyre dhe shumë më tepër nevojitet të bëhet në sistemin e menaxhimit të humbjeve në rrjet
7. Në pjesën e ndryshimeve klimatike nevojitet të bëhet shumë më tepër në fillimin e zbatimit të legjislacionit.

Komisioni parlamentar për Bujqësi, Pylltari, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor mund të luaj rol shumë të rëndësishëm në monitorimet e zbatimit të legjislacionit në fushat e sipërpërmendura me theks të veçantë sa i takon fushës së menaxhimit të ujërave dhe kualitetit të ajrit, në cilat në masë të madhe varen nga niveli qëndror dhe ku adresa është më e definuar. Në pjesën e ndryshimeve klimatike, Komisioni duhet të insistojë në informata rreth hartimit dhe zbatimit të Planit të Kosovës për Reduktimin e Emisioneve.

Pjesa e mbrojtjes së mjedisit është një fushë e cila kërkon veprim të përbashkët të më shumë se një komisioni. Në pjesën e mbrojtjes së pyjeve dhe biodiversitetit nevojitet koordinim në mes të Komisionit për Bujqësi, Pylltari, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor dhe Komisionit për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri. Për shembull, pa një përpjekje serioze të dyja komisioneve nuk mund të ketë harmonizim të legjislacionit për mbrojtje të lumenjëve për shkak se njëri komision e ka nën fushëveprim legjislacionin që rregullon fushën e mbrojtjes së ambientit dhe mbrojtjes së lumenjëve ndërsa tjetri atë të sektorit minerar në Kosovë.

Përpjekja e përbashkët e Komisioneve do të mund të hapte debatin për një sërë temash të aspektit zhvillimor dhe të balancimit të tij me aspektet ambientale. Komisioni Evropian ka identifikuar edhe mungesën e zbatimit të Ligjit Nr. 04/L-174 për Planifikimin Hapësinor si një nga sfidat më të mëdha me të cilat përballet mbrojtja e ambientit në Kosovë. Kjo me theks të veçantë në mbrojtjen e tokave bujqësore. Kjo do të kërkojë angazhim të komisionit në punë me Ministrinë e Bujqësisë, atë të Pushtetit Lokal dhe komuneve të Kosovës në mënyrë që të ketë rezultate më të mëdha.

#### 4. Agjencitë e pavarura

Si edhe çdo vit tjetër, Raporti i Komisionit Evropian vë në dukje problemet që ndërlidhen me mbikëqyrjen parlamentare ndaj institucioneve të pavarura. Përmes formës së raportimit të iniciuar nga Komisioni parlamentar për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri është bërë një hap i mirë në standardizimin e formës së raportimit për agjenci të pavarura.<sup>6</sup> Kjo formë e raportimit bashkë me formën e raportimit financiar po aplikohen tashmë për agjencitë e pavarura. Megjithatë, nevojitet që të ndërmerren hapa shtesë në vlerësimin efektiv të kualitetit të raporteve vjetore.

*Kuvendi ka dështuar që në mënyrë të duhur të mbikëqyrë institucionet e pavarura, autoritetet rregullatorë dhe agjencitë, raportet e të cilave shpesh kalohen pa marrë në konsideratë plotësisht rezultatet e debatit. Mungesa e mandateve të qarta, raportimit të duhur dhe mekanizmave të*

<sup>6</sup> Komisioni parlamentar për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri i Republikës së Kosovës, (2014), Rekomandime Nr. 04/5364/90-2245 lidhur me funksionimin e rregullatorëve dhe agjencive të pavarura që i raportojnë Kuvendit: Prishtinë.

***llogaridhënes, si dhe fragmentimi institucional, vazhdojnë të paraqesin problem për mbikëqyrje dhe reforma efektive. (Komisioni Evropian).***

Kuvendit qartësisht i mungon një mekanizëm i mirëfillt kontrolli ndaj agjencive të pavarura. Raporti vjetor, që është mjeti pothuaj i vetëm i Kuvendit për të mbikëqyrur punën e agjencive të pavarura ende nuk është një mjet i fuqishëm mbikëqyrës. Kjo për arsye se në njërin anë për shumicën absolute të agjencive të pavarura ligji nuk parasheh asnjë masë ndëshkuese në rast të mosaprovimit të raporteve vjetore, dhe në anën tjetër nuk ka një standard të qartë të vlerësimit të këtyre raporteve dhe përmbajtjes së tyre.

## **Përfundime**

Komisioni për Bujqësi, Pylltari, Mjedis dhe Planifikim hapësinor është prej komisioneve me sfidat më të mëdha në procesin e integritimit evropian. Këto ndërlidhenjo vetëm me gjendjen e përgjithshme në fushat si bujqësia, pylltaria, mjedisi e planifikimi hapësinor por edhe për shkak se trajtimi i tyre nga aspekti ligjor dhe praktik kërkon edhe kapacitete më të mëdha të Komisionit por edhe bashkëpunim më të gjerë me komisione të tjera dhe institucione. Komisioni mund të organizojë tryeza të përbashkëta diskutimi dhe aktivitete të përbashkëta të monitorimit të zbatimit të legjislacionit në mënyrë që të ketë rezultate më të efektshme.

Në pjesën e bujqësisë Komisioni mund të fokusohet në dy fusha kryesore. E para të punojë në monitorimin e thukhtë të ndihmave shtetërore dhe të subvencioneve në bujqësi. Kjo duhet bërë në atë mënyrë që të kërkojë llogari nga ana e Ministrisë së Bujqësisë bie fjala se përse ende importojmë produkte të cilat me vite janë subvencionuar. Komisioni të shikojë mundësinë e angazhimit të ndonjë eksperti që do të vlerësojë efektin ekonomik të subvencioneve në bujqësi, aplikimin e tyre dhe të sygjerojë ndryshimet e nevojshme.

Tek bujqësia një tjetër element në të cilin Komisioni duhet të fokusohet është inicimi i politikave që inkurajojnë rritjen e parcelave bujqësore në atë mënyrë që të inkurajohet prodhimtaria bujqësore. Komisioni veçanërisht duhet të fokusohet në monitorimin e zbatimit të Ligjit Nr. 02/L-26 për Tokën Bujqësore dhe Ligjit Nr. 04/L-040 për Rregullimin e Tokave. Të dyja këto ligje përbëjnë bazë shumë të mirë që Komisioni të inicojë ndryshime në pjesën e rehabilitimit dhe mbrojtjes së tokave bujqësore dhe bashkimit të tokave.

Komisioni duhet të fillojë procedurat për monitorimin e zbatimit të Ligjit Nr. 2003/3 për Pyjet e Kosovës, plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin Nr. 03/L-153 për Plotësimin dhe Ndryshimin e Ligjit për Pyjet e Kosovës. Në të njëjtën kohë komisioni përmes thirrjes në përgjegjësi ndaj ministrit duhet të kërkojë përgjegjësi për punën e Agjencionit të Pyjeve që funksionon nën Ministrinë e Mjedisit. Në anën tjetër, komisioni mund të inicojë një diskutim me komunat rreth sistemeve të ngrohjeve qendrore si masë për promovimin e zhvillimit të qëndrueshëm të pyjeve.

Komisioni duhet të punojë me agjenci të pavarura. Këto agjenci, si Bordi Këshilldhënës për Mbrojtjen e Mjedisit, Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale et., luajnë rol thelbësor në pjesë të rëndësishme të mandatit të Komisionit dhe si të tilla duhet të kenë vëmendjen e tij. Aktivitete të përbashkëta për mbrojtjen e lumenjëve mund të organizohen me KPMM-në dhe ministritë relevante.



---

*“Kjo analizë është financuar nga projekti Promovimi i Shoqërisë Demokratike (DSP) – i financuar nga Zyra Zvicerane për Bashkëpunim në Kosovë (SCO-K) dhe Ministria e Punëve të Jashtme e Danimarkës (DANIDA) dhe menaxhuar nga Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF)”.*